

Cila grupe mund të luten për më shumë se një shkollë?

Të gjitha grupet mund të luten për më shumë se një shkollë, duke përfshirë dhe grupet tradicionale. Kjo eshtë një zgjedhje shumë e mirë pér mama që ende nuk kanë gjetur një mama me të cilën të luten pér shkollën e fëmijëve të tyre. Pastaj kur një mama tjetër të gjendet ato të dyja mund të zhvillojnë grupin e tyre.

Si mund të regjistroj të gjitha shkollat?

Të gjitha shkollat për të cilat lutemi rregullisht gjatë kohës për Shqetësimet e Shkollave duhet të regjistrohen. Kjo perfshin grupet tradicionale, grupet e gjysheve, grupet e kishës, grupet e nënave në punë, grupet e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Për të regjistruar secilën shkollë perfshi NJË shkollë në hapësirën EMRI I SHKOLLËS, pastaj vendos GJITHË SHKOLLAT E TJERA në sektorin e KOMENTEVE.

Si duhet ta organizoj hapësirën për shkollat kur është më shumë se një shkollë për tu lutur për?

Gjatë kohës së ndërmjetësimit, grupet mund të ndahen sipas shkollave ose moshave të fëmijëve. Drejtuesja mund te shkruaj një kërkesë të përgjithshme te SHQETËSIME PËR SHKOLLEN në Fletën e Lutjeve, dhe secila nënë mund ta përshtash me shkollën e fëmijës. Këto kërkesa të përgjithshme për lutje mund të përfshijnë sigurinë, përzgjedhjen e programit, promblemet me drejtimin e shkollës, unitetin midis stafit, ngjarje të lidhura me pushimet etj. Nëse një mama ka një kërkesë të rëndësishme për shkollën, ajo mund t'ia jap drejtieses para se të fillojnë në mënyrë që të mund të vendoset ne Fletën e Lutjeve, ose ajo mund të lutet për këtë kërkesë me grupin e saj prej dy ose tre vetash gjatë kohës e Shqetësimeve për Shkollën.

A duhet të regjistrohem te shkolla/shkollat për të cilat nuk ka nëna në grup që ka fëmijë në atë shkollë?

Symimi i Nënave në Lutje Ndërkombëtare është që të mund të lutet për cdo shkollë. Prandaj, kërkojmë që çdo grup, dhe grupet që po luten për femijë që nuk janë në shkollë, të vendosin një shkollë për te cilën do të luten. Kjo mund të jetë shkolla e mëparshme ose e ardhshme e fëmijës, një shkollë e afërt ose një shkollë që është në zemrën tende.

Megjithatë, ndonjëherë një grup mund të listojë të gjitha shkollat në territorin e tyre sikur të ishin duke u lutur për to.

Ju lutem listoni vetëm shkolla për të cilat luteni. Qëllimi ynë është që çdo shkollë të jetë e mbuluar në lutje, dhe është e rëndësishme të dimë për cilat shkolla lutemi dhe për kë jo..

çfarë ndodh nëse një nënë nga një shkollë e “adoptuar” kërkon ti bashkohet grupit?

Nëse jeni duke u lutur për një shkollë në të cilën asnjë nga fëmijët e anëtarëve nuk ndodhen aty, lloji i grupit tuaj do te shfaqet te Treguesi i Grupit, si Plangprishës ose Ushtrie.

Nëse një nënë nga ajo shkollë ju kontakton për tu bashkuar, ju lutem tregojini sa të emocionuar jeni pasi ajo është përgjigjja e lutjeve tuaja! Sqaroni që grupi juaj lutet për shkollën por fëmijët tuaj janë më të mëdhenj. Si drejtuese, mund të duash ta takosh dhe të lutesh me të dhe ta ndihmosh të gjej një grup tjetër ose një mama. Ju lutem lidheni atë më një Kordinatore të Nënave Në Lutje, Kordinatore Rajonale, ose Drejtore Rajonale.